35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jetë dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36

Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktojnë jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 615-25-41-5-1-1/C1213


KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 66,499.52€ në kohëzgjatje prej duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës deri më 09.11.2026
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 ditë nga koha e nënshkrimit të kontratës
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë sipas planit dinamik në Dt e që është 360 ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.

		Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Caktohet nga ZKA brenda 3 dite
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: N/A
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë nga koha e pranimit të punëve. 10% shumës së Kontratës
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega Podujeve në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Projekti: Ndërtimi i SHFMU "Jetullah Gashi" në fshatin Dobërdol

PARAMASA ME PARALLOGARI					
Pjesë përbërëse e paramasë janë edhe: PËRSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE. Vërejtje: Çmimi për çdo pozicion duhet të përfshijë: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit në gjendje plotësisht funksionale, garancionin, testimet si dhe kompletimin e certifikatave dhe atesteve të prodhuesëve. Në çmim duhet të kalkulohet gjithashtu i tërë materiali shpenzues deri në lëshuarjen në funksion. Llogaria e sasive përfundimtare do të bëhet me liber ndërtimor pas përfundimit të tërësishëm të pozicionit.					
Masat e sigurisë: Duhet të jenë në nivelin më të lartë për arsye të ruajtjes së shëndetit të personave që punojnë dhe jetojnë afër punishtës. Pra në këtë mënyrë duhet të bëhet sigurimi i punishtës dhe vendosjes së materialeve në të si dhe të mirren masat e nevojshme të sigurisë (preventiva) hapësinore në mes të zonës nën ndërtim dhe zonave të tjera të cilat mbeten në shfrytëzim gjatë fazës së punimeve.					
Punishlja të shenjzohet dhe të vendosen tabela prej llamarine dhe me konstruksion të përforcuar mirë në tokë. Para fillimit të punimeve punëkryesi duhet që në kosto të parasheh edhe çkycjen e instalimeve eksistuese në fillim të ekzekutimit të punimeve si dhe rikycjen e instalimeve pas realizimit të punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme për konzervimin të instalimeve ekzistuese të cilat ngelen në shërbim (funksion) gjatë dhe pas realizimit të punimeve.					
Për secilin pozicion ku janë përmendur karakteristikat teknike të prodhuesit mund të përdoren materiale me karakteristika të ngjajshme të prodhuesve të ndryshëm në ndryshëm në përputhje me standardet EC dhe ISO.					
Dimensionet për realizim gjithmonë të merren në vend.					
Aplikuesi duhet të ketë / dëshmojë staf të kualifikuar teknik për realizim të projektit.					
Produktet e propozuara të gjitha duhet përcillen me certifikatë kualiteti të prodhuesit.					
Duhet të përbushin ISO standardet.					
ARKITEKTURA					
A					
1	PUNËT PËRGADITORE				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Total (€)
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes, paisjeve dhe materialeve për realizimin e punimeve, përgaditja e punishtës dhe miremëbajtja e saj gjatë periudhës së implementimit të punimeve.	Komplet	1,00	85,00	85,00 €
1.2	Inqizimi i parcelës në vendin e parapare për ndërtimin e shkollës dhe murit rezistues, si dhe bartja e pikave nga projekti në terren në bashku me organin mbikqyrës.	Komplet	1,00	120,00	120,00 €
1.3	Sigurimi i gropës ndërtimore për murin rezistues nga shembja e dheut konform normave ndërtimore në fuqi. Poashtu në çmim përfshihet edhe vendosja e shenjave sinjalizuese për punimet në terren, një në fillim të murit dhe një në mbarim të murit.	Komplet	1,00	8,00	8,00 €
1.4	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohëshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriqimit të kantierit.	Komplet	1,00	170,00	170,00 €
1.5	Punimi i rrethojës së kantierit. Rrethoja duhet punuar me material të qëndrueshëm me llamarinë se zingtuar me lartësi 2 m.	m'	245,00	1,30	318,50 €
1.6	Sinjalizimi i punishtës (sipas standardeve të ndërtimit), hyrje daljet në punishtë, truget për qasjen dhe qarkullimin e materialeve, duke parapar edhe montimin e tabelës informuese (llamarinës dhe me konstruksion të përforcuar mirë në tokë) me emrin e projektit, investitorit, punëkryesit, vlera e investimeve, data e fillimit të punimeve si dhe data e mbarimit të punimeve. Në çmim të merren parasyshe edhe shenjat lajmeruese për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë. Kujdes të veçantë duhet kushtuar para hyrjes kryesore të objektit	Komplet	1,00	127,00	127,00 €
1.7	Punimi i objekteve përcjellëse për nevoja të kantierit. Këtu përfshihen hapësira zyrtarë dhe menaxhimit të kantierit, mbikëqyrësin si dhe hapësirat për punëtorë (garderobat dhe trapezaria)	Komplet	1,00	170,00	170,00 €
1.8	Pastrimi i parcelës nga mbeturinat e mundshme, materiali largohet në depoti legale.	Komplet	1,00	212,00	212,00 €



1,9	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntoksore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detaj operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në cmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektroteknike për instalime nëntoksore si dhe evidentimi i sakte i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit (rrjeti elektrik, rrjeti i ujësjellsit, kanalizimit etj.)	Komplet	1,00	170,00	170,00 €
TOTALI POSICIONI:					1.380,50 €
2	PUNËT E DHEUT DHE MBUSHJA				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
2,1	Gërmimi i gjerë i dheut(humusit) në thellësi mesatare h=40 cm për rrafshimin e terrenit, ku do të ndërtohet objekti i shkollës. Materiali i gërmuar largohet në deponi legale të përcaktuara nga organi mbikqyrës.	m³	320,00	2,15	688,00 €
2,2	Gërmimi i dheut të kategorisë së III, IV dhe V-të për hapjen e themeleve shiritore të objektit shkollor. Largimi i të njëjtit në largësi brenda kantierit për përdorim në rregullimin e oborrit, pjesa e teperet dhe e padobishme largohet në deponi legale të përcaktuara nga organi mbikqyrës.	m³	690,00	2,60	1.794,00 €
2,3	Gërmimi i dheut i kategorisë së IV-V duke përfshirë edhe humusin me ngarkim dhe bartje deri në deponi i një pjesë në afërsi për kthim pas vendosjes së murit mbrojtës(rezistues) kurse pjesën e tepruar duke e larguar në largësi min 10km	m³	240,00	3,00	720,00 €
2,3	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-100 mm nën themelet mbi dheun e ngjeshur me mekanizim përkatës.	m³	180,00	12,00	2.160,00 €
2,3	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-62 mm nën themelet e objektit dhe murit mbrojtës në trashësi d= 20,0 cm mbi shtresën e ngjeshur me mekanizim përkatës.	m³	280,00	11,00	3.080,00 €
2,4	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-32 mm nën themelet objektit dhe murit mbrojtës në trashësi d= 10,0 cm e ngjeshur me mekanizim përkatës.	m³	140,00	12,00	1.680,00 €
2,5	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-62 mm në trashësi d= 60,0 cm mbi dheun e ngjeshur, përreth çokllës nën pllaken e dysheme së objektit, ngjeshur me mekanizim përkatës.	m³	990,00	11,00	10.890,00 €
2,6	Furnizimi, hudhja dhe ngjeshja e zhavorit 0-32 mm në trashësi d= 15,0 cm i ngjeshur me mekanizim përkatës nën pllaken e dysheme së objektit.	m³	110,00	12,00	1.320,00 €
2,7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e materialit drenazhues mbrapa murit mbrojtës Fraksioni III-IV të vendosur në thes prej rrëte të plastikës.	m³	19,20	5,00	96,00 €
2,8	Furnizimi, transporti dhe vendosja e argjilës së ngjeshur për drenazhim të muret mbrojtëse në trashësi t=20cm.	m³	9,60	5,00	48,00 €
2,9	Kthimi i dheut me pare të gërmuar rreth murit mbrojtës, ngjeshja të bëhet në shtresa max 25cm.	m³	96,00	3,00	288,00 €
TOTALI POSICIONI:					22.764,00 €



3	PUNËT E BETONIT				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
3,1	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shtresës së betonit me beton të ngjeshur C15 Mpa në trashësi d=4-6 cm nën themelet shiritore të objektit shkollor dhe murit mbrojtës, e cila shërben si shtresë mbrojtëse e armaturës.	m³	27,00	70,00	1.890,00 €
3,2	Furnizimi me beton C-30/37 dhe punimi i mureve mbrojtës (rezistues) sipas detalave për ekzekutim. Në çmim të përfshihen aditivi, latimi, vibërimi dhe demontimi i pahive. Llogariten në metër kub të punuar.	m³	50,12	15,00	751,80 €
3,3	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve shiritore, çokllës dhe pllakës së dyshemes të objektit shkollor me beton të armuar C 25/30 Mpa në pahitë përkatëse sipas projektit. Sipërfaqja e jashtme e pahive të jetë e lëmuar.	m³	612,00	79,00	48.348,00 €
3,4	Furnizimi, transporti, latimi dhe betonimi i trajeve dhe pllakave konstruktive të objektit shkollor me trashësi t=23.0 cm me beton të armuar C25/30 Mpa, për katin e parë dhe pllakën e kufiut, me pahitë përkatëse sipas projektit. Sipërfaqja e pahive të jetë e lëmuar.	m³	360,00	79,00	28.440,00 €
3,5	Furnizimi, transporti, latimi dhe betonimi i shtyllave me beton të armuar C25/30 MPa në kallupet përkatëse sipas projektit.	m³	63,00	79,00	4.977,00 €
3,6	Furnizimi, transporti dhe betonimi i elementeve tjera konstruktive si parahyrtet, hyrjet shkallët arkitrajet etj. Me beton C25/30 në kallupet përkatëse sipas projektit.	m³	52,00	79,00	4.108,00 €
TOTALI POSICIONI:					88.514,80 €
4	PUNËT E ARMATURES				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
4,1	Furnizimi, transporti, prerja si dhe vendosja e ARMATURES ÇBR-400/500 Mpa në tërësi në të gjitha pozicionet sipas llogarisë statike.	kg	104125,73	0,85	88.506,87 €
4,2	Furnizimi, transporti, prerja dhe vendosja e rrjetave Q-335 në të dy zonat me specifikacion Ø8.6x15x15 cm 5.94 kg/m2 me palim 40 cm.	kg	5268,30	0,85	4.478,05 €
					92.984,92 €




5	PUNËT E MURATIMIT DHE SUVATIMIT				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
5,1	Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve të jashtme dhe të mbrendshme me blloka të argjës d=25cm me llaq vazhdues në përpjesë 1:2:6 në tërësi sipas projektit .	m ³	243,00	61,00	14.823,00 €
5,2	Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve të mbrendshme me blloka të argjës d=20cm me llaq vazhdues në përpjesë 1:2:6 në tërësi sipas projektit .	m ³	45,00	61,00	2.745,00 €
5,3	Furnizimi, transporti dhe muratimi i mureve të mbrendshme me blloka të argjës d=12cm , muri me llaq vazhdues në përpjesë 1:2:6 në tërësi sipas projektit.	m ³	20,00	140,00	2.800,00 €
5,4	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të brendshme dhe plafonit me llaq gelqeror në përpjesë 1:3 në dy shtresa me finalizim të lëmuar.Ne pozicion të parashihet vendosja e kendoreve ne këndet e mureve.	m ²	3563,43	11,00	39.197,73 €
TOTALI POSICIONI:					59.565,73 €
6	PUNËT E KULMIT				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
6,1	Furnizimi, punimi dhe montimi i konstruksionit të kulmit. Komplet mbi pllakë nga druri i përpunuar me: Mahitë=10/12cm/; Nënmahitë=12x14cm;Shtyllat=12x14cm Shtangimet=12x12cm; danat=(15x7)x2cm.; në tërësi sipas projektit. Llogaria në sipërfaqe te rrafshet m ² .	m ²	776,00	20,00	15.520,00 €
6,2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e dërrasave t=24mm mbi konstruksionin kulmit, si bazament për vendosjen e letërës difuzive dhe listelave. Llogaria në m ²	m ²	776,00	6,00	4.656,00 €
6,3	Furnizimi dhe vendosja e kontra listelave 2/4 cm në çdo 70cm mbi dyshemenë e dërrasave per krijimin e sipërfaqes ajruese . Llogaria në sipërfaqe te rrafshet m2	m ²	776,00	0,40	310,40 €
6,4	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e letërës difuzive 110gr/m ² mbi sipërfaqen paraprakisht të mveshur me dërrasa të konstruksionit te kulmit, perfshire te gjitha punët përgatitore. Llogaria në sipërfaqe te rrafshet m2	m ²	776,00	0,90	698,40 €
6,5	Furnizimi dhe vendosja e listelave 5/8 në çdo 80 cm mbi kontralistela. Llogaria në sipërfaqe te rrafshet m2	m ²	776,00	1,50	1.164,00 €
TOTALI POSICIONI:					22.348,80 €



7	PUNËT E LLAMARINËS				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
7,1	Furnizimi, transporti dhe punimi i mbulesës së kulmit të objektit shkollor. Me llamarinë të plastifikuar dhe valëzuar d=0.55mm me brinjë t=4cm - "Tip T50" (100% e mbulesës), përshi kulmaret, aksesoret përcjellës për kompletim, dhe me shtresën kundër kondenzit, ngjyrë sipas zgjedhjes së investitorit. Llogaria në m ² në sipërfaqe të rrafshët.	m ²	776,00	12,00	9.312,00 €
7,2	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulukëve horizontal nga llamarina e plastifikuar t=0.55mm.	m'	183,50	8,00	1.308,00 €
7,3	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulukëve vertikal nga llamarina e plastifikuar me dimensione Ø12cm, t=0.55mm	m'	105,00	8,00	840,00 €
7,4	Furnizimi transporti dhe montimi i llamarinës së plastifikuar me ngjyrë sipas investitorit për punimin e mveshjeve të oxhakut	Copë	1,00	170,00	170,00 €
TOTALI POSICIONI:					11.630,00 €
8	PUNËT E HIDROIZOLIMIT DHE TERMOLIZOLIMIT				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
8,1	Furnizimi, transporti dhe punimi i hidroizolimit horizontal me saldim të lidhjeve në pilaken e dyshemës, të objektit shkollor, hidroizolimi punchet me material hidroizolues shumëshresor - tipi kondor, t=4mm dhe me një shtresë lysterje bituliti. Llogaria në m ² , në llogari të merren paraprkishtë izolimi edhe para vendosjes së muraturës.	m ²	650,00	8,00	5.200,00 €
8,2	Furnizimi, transporti dhe izolimi i dyshemës dhe mureve në nyjet sanitare me izolim dy komponentesh dhe të gjitha punet përcjellëse.	m ²	505,00	9,00	4.545,00 €
8,3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e lesh gurit të objektit shkollor. Me trashësi t=10cm, ndërmjet murit me blloqet nga argjilla dhe tullës së fasadës së jashtme.	m ²	550,10	11,00	6.051,10 €
8,4	Furnizimi, transporti dhe punimi me stiroprit N4 i fasadës së jashtme për objektin shkollor, me trashësi t=16cm sipas projektit. Në çmim të llogarit ngjites dhe elementet lidhëse-tiplat.	m ²	140,00	17,00	2.380,00 €
8,5	Furnizimi, transporti dhe punimi me stiroprit N4 i fasadës së jashtme në pjesët e nën terasave, shtyllave dhe simsit për objektin shkollor, me trashësi t=5 cm sipas projektit. Në çmim të llogarit ngjites dhe elementet lidhëse-tiplat.	m ²	170,00	11,00	1.870,00 €
8,6	Furnizimi dhe vendosja e materialit termoizolues (styroodur) me trashësi t=8.0 cm e cila vendoset përreth xokules së objektit shkollor h=50cm.	m ²	155,00	12,00	1.860,00 €
8,7	Furnizimi dhe vendosja e materialit termoizolues me trashësi t=4.0 cm 2x2 e cila vendoset mbi pllaken e përdhësës, katit I dhe kulmit, të objektit shkollor, sipas projektit. Në çmim të llogarit edhe shtresa mbrojtëse e termoizolimit folja plastike.	m ²	1980,00	4,30	8.514,00 €
TOTALI POSICIONI:					30.420,10 €



9	PUNËT E ZDRUKTHËTARISË	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
Poz.	Përshkrimi i pozicionit				
9.1	Furnizimi dhe montimi i dritareve prej materialit të plastikës me trashësi të profilit t=8.0cm me min. 5 komora (hapesira termike) dhe tre mbyllje gome. Plastika të jetë e perforuar me profil të çelikut (d=2mm), adekuat për profilin e caktuar të PVC-së. Profili duhet të arrijë vlerat Uf prej 1.3 W/m2. Dritaret do të jenë me XHAM TË TREFISHT 4+16+4+16+4 mm, Uw=0,8 ë.m-2K-1 mbushje me argon, Ug=0,6 ë.m-2K-1, izolimi akustik Rë-34 dB. Mekanizmi për hapje jo më lartë se 175 cm. Të aplikohet sistemi katërshresor mbrojtës me impregnim të thellë.				
9.1.1	Pos 1 me dimensione 200*295 cm	copë	30,00	400,00	12.000,00 €
9.1.2	Pos 2 me dimensione 200*200 cm	copë	6,00	300,00	1.800,00 €
9.1.3	Pos 3 me dimensione 200*360 cm	copë	2,00	530,00	1.060,00 €
9.1.4	Pos 4 me dimensione 200*180 cm	copë	2,00	300,00	600,00 €
9.1.5	Pos 5 me dimensione 200*100 cm	copë	1,00	210,00	210,00 €
9.1.6	Pos 6 me dimensione 200*90cm	copë	11,00	120,00	1.320,00 €
9.1.7	Pos 7 me dimensione 80*80cm	copë	12,00	100,00	1.200,00 €
9.1.8	Pos sportelli me dimensione 80*100cm	copë	1,00	100,00	100,00 €
9.2	Furnizimi, punimi dhe montimi i dritareve hyrëse dhe erembrojtësit nga profilit e aluminit termik të elokuara me ngjyrë antracid, alumini i tipit (M11500,70000 Serie, apo i ngjashëm). Xham termopan 4+16+4, xhami i jashtëm 4mm transparent, xhami i brendshëm transparent 4mm, hapësira e vakumit e mbushur me gaz argon. Dyeritë me hapje ventus nga brenda me dorëza të gjata për hapje, me gërshërë sigurorese, gomë perimetrike EPDM, dorëza dhe mentesha kualitative. I tërë pozicioni të punohet dhe montohet sipas projektit kryesor/skemës së hapjeve dhe udhëzimeve të prodhuesave të certifikuar me EN standarde. Llogaritet në copë të derës së montuar.				
9.2.1	Pos A me dimensione 300*360 cm	copë	1,00	1000,00	1.000,00 €
9.2.2	Pos A' me dimensione 280*360 cm	copë	1,00	1000,00	1.000,00 €
9.3	Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme nga mediapani i kualitetit të lartë me hapje nga xhami 60x40cm, me korniz metalikeme gjërsia t=25cm, me mekanizëm për hapje dhe mbyllje me çelës dhe të gjitha elementet tjera përcjellëse.				
9.3.1	Pos B me dimensione 210*90 cm	copë	11,00	210,00	2.310,00 €
9.3.2	Pos C me dimensione 210*90 cm	copë	11,00	210,00	2.310,00 €
9.4	Furnizimi dhe montimi i dyerve të Njësive Sanitare nga PVC profillet. Profili me diametër të bazës Min. 8cm, me min. 5 komora (hapesira termike) dhe tre mbyllje gome. Plastika të jetë e lidhur me profil të çelikut adekuat për profilin e caktuar. Profili duhet të arrijë vlerat Uf prej 1.3 W/m2. Paneli thermopan dizajni i të ciles duhet të jetë i afert me projektin zbatues. Dyeritë duhet të ankorohen me buçona të galvanizuar.				
9.4.1	Pos D me dimensione 210x90 cm	copë	7,00	150,00	1.050,00 €
9.4.2	Pos E me dimensione 210x80 cm	copë	19,00	160,00	3.040,00 €
9.4.3	Pos F me dimensione 210x100 cm	copë	1,00	180,00	180,00 €




9,5	Furnizimi dhe montimi i derës të hyrja e parashkollloreve prej profileve të aluminit termik të elokuara me ngjyrë antracid ,alumini i tipit (M11500,70000 Serie, apo i ngjashëm). Xham termopan 4+16+4, xhami i jashtëm 4mm transparent , xhami i brendshëm transparent 4mm, hapësira e vakumit e mbushur me gaz argon. Dyer të me hapje ventus nga brenda me dorëza të gjata për hapje, me gërshërë siguruëse, gomë perimetrike EPDM, doreza dhe mentesha kualitative. I tërë pozicioni të punohet dhe montohet sipas projektit kryesor/skemës së hapjeve dhe udhëzimeve të prodhuesëve të certifikuar me EN standarde. Llogaritet në copë të derës së montuar.				
9.5.1	Pos G me dimensione 300x150 cm	copë	1,00	535,00	535,00 €
9,6	Furnizimi dhe montimi i derës të hyrja në kallda prej profileve të aluminit të elokuara me ngjyrë antracid ,alumini i tipit (M11500,70000 Serie, apo i ngjashëm). Xham termopan 4+16+4, xhami i jashtëm 4mm transparent , xhami i brendshëm transparent 4mm, hapësira e vakumit e mbushur me gaz argon. Dyer të me hapje ventus nga brenda me dorëza të gjata për hapje, me gërshërë siguruëse, gomë perimetrike EPDM, doreza dhe mentesha kualitative. I tërë pozicioni të punohet dhe montohet sipas projektit kryesor/skemës së hapjeve dhe udhëzimeve të prodhuesëve të certifikuar me EN standarde. Llogaritet në copë të derës së montuar.				
9.6.1	Pos H me dimensione 250*160 cm	copë	1,00	500,00	500,00 €
				TOTALI POSICIONI:	30.215,00 €
10	PUNËT E GLETIT DHE FASADËS	Njësia matëse	Sasla	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
Poz.	Përshkrimi i pozicionit				
10,1	Furnizimi, transporti dhe ekzekutimi i gletit të të gjitha mureve të brendshme dhe pllafoneve në objektin shkollor, në dy shtresa (ketu nuk parashihen muret të nyjet sanitare), paraprakishte të behet pergaditja me lëndën bazë, sipërfaqja duhet të jetë e lëmuar dhe e gatshme për ngjyrosje.	m²	3563,43	3,60	12.828,35 €



10,2	Furnizimi, transporti dhe ekzekutimi i fasadës termike demit (ne llogari te merret rrjetë rabric, llaq i plastifikuar dhe ngjyra) në nuansë sipas përzgjedhjes së projektuesit ose investitorit.	m²	301,44	12,00	3.617,28 €
10,3	Furnizimi, transporti dhe ekzekutimi i kulirit ne pjesen e coklës se themeleve (ne llogari te merret rrjetë rabric, llaq i plastifikuar dhe ngjyra) në nuansë sipas përzgjedhjes së projektuesit ose investitorit.	m²	155,00	10,00	1.550,00 €
10,4	Furnizimi me material si dhe punimi i fasadës me tullë , (Tullë e plotë jo e zgavruar , me ngjyrë të njëtrajshme vjollcë të kuqërremtë dhe njolla blu në të zezë (Parma). Sipërfaqe me relief). Prodhuar BE (Vandersanden apo të ngjashme) -Tullë të fasadës me dimensione +/- 210 x 50 x 65 mm; -Absorbim uji <=14% m³md - Sipërfaqe me relief -Thithja fillestare të ujit 1.5-4.0 kg/m².min(W3);EN771-1:2011 -Rezistenca ndaj ngrirjes / shkrijes B27-009 Montimi të bëhet me shtresat si në vijim: Termoizolimi iesh guri 10cm 75gr/m²; foli gjeotekstil 250gr/m²; hapësirë ajrore 3-5 cm dhe tullë me t=5 cm. Në kuadër të punimeve të llogarit punimi i fugave të muratimit me ngjyrë hiri , lineare të rregullta, me trashësi 12mm - nga llaqi i çimentos dhe me ngjyrë përkatëse. Në llogari të merren edhe 5 ankorime metalike për 1m² në sipërfaqe të fasadës, vrima të ajërimit sipas standardeve, përfshirë gjithashtu formalizimet sipas projektit dhe të gjithë ankerët dhe aksesoret e nevojshëm. Të përfshihen edhe elementet përforcuese mbi dyerë e dritare nga materiale jo-korodive , profili horizontal me ankerët e nevojshëm nga metal në formë "L" për krijim të bazës së vendosjes.	m²	550,10	68,00	37.406,80 €
TOTALI POSICIONI:					55.402,43 €

11	PUNËT E NGJYROSJES	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
Poz.	Përshkrimi i pozicionit				
11,1	Furnizimi, transporti dhe ngjyrosja e mureve, pilafoneve të kthinave mbi bazament të gjetuar te objekti shkollor, me polikolor ne dy shtresa me nuancë të bardhë.	m²	3563,43	1,80	6.414,17 €
11,2	Furnizimi, transporti dhe lyerja e mureve te kthinave dhe koridoreve me ngjyre te yndyrshme ne lartesi h = 1.0 m'	m²	980,00	3,00	2.940,00 €
TOTALI POSICIONI:					9.354,17 €



12 PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT					
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
12,1	Furnizimi, transporti dhe mveshja e shkallëve të brendshme me panele nga Graniti Natyral klasa e parë, shkelësja dhe pushimoreve me trashësi t=3cm; ballorja t=2cm. Montimi bëhet me llaq çimento. Ngjyra me nuançe të përafërt dyshemenë. Në çmimit të llogaritet të gjitha punët e nevojshme për këtë pozicion. Llogaritet në metër katror.	m²	24,80	62,00	1.537,60 €
12,2	Furnizimi, transporti dhe mveshja e mureve (sanitaret) të objektit shkollor, me pllaka të keramikës të kualitetit të lartë. Dizajni sipas investitorit	m²	460,00	21,00	9.660,00 €
12,3	Furnizimi, transporti dhe mveshja e dyshemeve (sanitaret) të objektit shkollor, me pllaka të keramikës të kualitetit të lartë. Dizajni sipas investitorit	m²	75,00	22,00	1.650,00 €
12,4	Furnizimi, transporti dhe mveshja e dyshemesë me pllaka të keramikës (dyshemeja në hapsirën e kuzhinës, depos dhe kaldatores) me llaq të çimentos. Në llogari të merret edhe punimi i perimetrit h=10.0 cm	m²	60,00	21,00	1.260,00 €
12,5	Furnizimi, transporti dhe mveshja e shkallëve, rampës dhe pjesëve hyrëse (hyrja kryesore, hyrja e parashkollëve dhe hyrja të kaldaja) me panele nga Graniti Natyral klasa e parë, shkelësja me trashësi t=3cm; ballorja t=2cm, hyrjet dhe rampat me t=2.0cm. Pllakat duhet të jenë jo rrëshqitëse dhe rezistente ndaj ngricave. Montimi bëhet me llaq çimento dhe ngjites në varesi të pozicionit. Ngjyra sipas OM. Pllakat duhet të jenë klasa e parë sipas standardeve EN 14411. Llogaritet në metër katror.	m²	137,00	68,00	9.316,00 €
TOTALI POSICIONI:					23.423,60 €
13 PUNËT E DYSHEMESE					
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
13,1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e PVC folis e cila duhet të vendoset mbi shtresën termoizoluese për punimin e estrihut.	m²	1980,00	0,40	792,00 €
13,2	Furnizimi i materialit, transporti dhe punimi i shtresës së estrihut në pllakën e dyshemes dhe kalit të objektit shkollor me makinë me trashësi 5-7cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese striporit t=4cm dhe shtresës hidroizoluese.	m²	1270,00	7,50	9.525,00 €
13,3	Furnizimi i materialit dhe punimi i shtresës mbrojtëse (estrih) të objektit shkollor me makinë me trashësi 4-5 cm mbi bazën e përgatitur të shtresave izoluese nën konstruksionin e kulmit.	m²	710,00	8,50	6.035,00 €
13,4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e dyshemesë linoleumit në klasa, hapsirën për parashkollor, bibliotek (në rolnë) lidhja bëhet me ngjitës adekuat, në llogari të merret shtresa vetënivelizuese, ngjitësi adekuat, diktuni dhe shiriti rreth perimetrit të mureve në lartësi h=8 cm.	m²	1040,00	12,80	13.312,00 €
TOTALI POSICIONI:					29.664,00 €




14 PUNËT E PARTERIT					
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
14,1	Gërmimi i humusit në thellësi prej 30 cm, gërmimi duhet të bëhet në sipërfaqen e trajtuar në pjesën grafike, si dhe transporti i dheut deri në deponi.	m³	175,00	3,00	525,00 €
14,2	Rrafshimi dhe nivelizimi i nënbazës së sipërfaqes së parterit me saktësi deri në ±2 cm, duke krijuar pjerresin e nevojshme terthore për kullimin e ujrave sipërfaqesore, ngjeshja me cilindër vibrues deri në arritjen e kompaktësis prej Ms= 30 Mpa.	m²	350,00	0,50	175,00 €
14,3	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri i thyer me frakison 0-63 mm me trashësi t=20 cm në gjendje të ngjeshur (Ms=40 Mpa).	m³	70,00	11,00	770,00 €
14,4	Furnizimi, transporti dhe ngjeshja e materialit nga guri i thyer me frakison 0-31.5 mm me trashësi t=10 cm në gjendje të ngjeshur (Ms=60 Mpa).	m³	35,00	11,00	385,00 €
14,5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kubzave me dimensione 20x20x6 cm me ngjyrë të hirit, në qmim të kalkulohet shtresa e reres frakslon 4 mm me trashësi t=5 cm dhe mbushja e fugave të kubzave me rer të imet. Llogarija në meter katrorë.	m²	350,00	12,80	4.480,00 €
14,6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e skajoreve me dimensione 8/20 cm për kufizimin e platos, në qmim të llogaritet betoni për shtangimin e skajoreve	m'	250,00	7,50	1.875,00 €
14,1	Furnizimi, transporti dhe mbjellja përzieje e barit për sipërfaqet me diell, i çertifikuar. Mbillet në thellësi 0,5 deri 1 cm dhe distancë 2-3 cm. Sasia e nevojshme për 1 m² është 20-25 g. Pas mbjelljes bëhet ngjeshja me cilindër 30-50 kg të rëndë dhe uji me kujdes të shtuar. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 20-25 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, teksture të mirë dhe pH neutrale (dobët acidike deri dobët bazike), e të cilës duhet shtuar edhe 2 -5 kg/m² tretës dhe 15-20 g/m² pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshatshme duhet të sillet dhe që i përmbush këto karakteristika në shtresë 15-20 cm. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues.	m²	350,00	1,30 €	455,00 €
TOTALI POSICIONI:					8.665,00 €



15	PUNËT TJERA				
Poz.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi (€)	Totali (€)
15,1	Furnizimi dhe punimi i oxhakut te ngrohjes qendrore d=500mm duke parapa edhe koken e tij dhe te gjitha elementet percjellese	m'	10,00	68,00	680,00 €
15,2	Furnizimi dhe montimi i derës për pastrim të oxhakut	cope	1,00	10,00	10,00 €
15,3	Furnizimi, transporti, dhe montimi i shkalleve te tavanit	cope	1,00	127,00	127,00 €
15,4	Furnizimi, transporti, dhe montimi drrasave nga druri i lemuar rreth e rreth perimetrin të klasave dhe koridorit për mbrojtje të murit. drrasat vendosen në lartësi nga dyshe meja 70 cm, ndërsa janë të gjër 20 cm me trashësi 2.4 cm.	m'	430,00	7,30	3.139,00 €
